



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic Of Kosovo



Komuna Rahovec / Opština Orahovac / Municipality Rahovec

REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLICA OF KOSOVO
RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Udëheqje të Opštës Upravu

Drejtoria për Shërbime Publike
Odeljenje za Opštinske Javne Usluge
Department of Municipal Public Services

Nr. I prot. 1273 Më 18.04.25
Br. prot. 1273 Dt. 18.04.25
RAHOVEC - ORAHOVAC

Datë/Datum/Date:	18.04.2025
Referenc-ë	
Për/Za/To:	Kuvendin e Komunës së Rahovecit
CC:	
Përmes/Preko/Through:	
Nga/Od/From:	z.Përparim Krasniqi, Drejtor për Shërbime Publike
Subjekti/Predmet/Subject:	Informatë



Informatë mbi implementimin e projektit të mirëmbajtjes dimërore dhe verore të rrugëve në Komunën e Rahovecit

Komuna e Rahovecit ka kontraktuar 2 kompani për mirëmbajtje të rrugëve gjatë sezonës dimërore dhe verore.

1. Periudha dimërore llogaritet nga data 15 nëntor deri me 15 mars të vitit që vie,
2. Periudha verore llogaritet nga 15 marsi i atij vitit deri me 15 nëntor.

Gjatë sezonës dimërore parashihen të mirëmbahen rrugët nga bora dhe akulli, si dhe hedhja e kripës industriale, ndërsa momentin që nuk ka borë kompanitë janë të detyruar të bëjnë pastrimin e rrugëve nga mbeturinat.

Ndërsa gjatë sezonës verore parashihen të mirëmbahen rrugët duke përfshirë larjen dhe pastrimin e brezave rrugore dhe trotuareve.

Sa i përket mirëmbajtjes dimërore të rrugëve komuna e Rahovecit e ka ndare në 2 lote mirëmbajtje të rrugëve urbane dhe atyre lokale;

Lot-1, 258,501.48 euro, KRM Ekoregjioni, kontrata (02.02.20204) është 3 vjeqare, janë në pozicion 106 segmente rrugore për mirëmbajtje dimërore.

Lot-2, 416,547.80 euro, Eko Drinia, kontrata (02.02.20204) është 3 vjeqare, ktu përfshihen pothuajse 33 pozicione apo me mire me then 33 fshatra.

KOMUNA RAHOVEC

Drejtoria për Shërbime Publike
Adresa: 8 Dëshmorët e Pashtrikut – p.n. Rahovec, Kosovë
Tel: +383 29 276 943
<http://kk.rks-gov.net/rahovec>

Sa i përket mirëmbajtjes dimerore kemi pasur aktivitet me 24 dhe 25 dhjetor 2024 ku llogaritet periudhe dimerore, ka pasur te resha te mëdha te bores, e ka vazhdu edhe ne vitin 2025 mirepo me intensitet te ulet.

Vazhdimisht kemi publikime te mirëmbajtjes se rrugëve dhe trotuare te gjitha këto bëhen publike përmes rrjeteve sociale.

Projekti i mirëmbajtjes së hapësirave publike

Projekti i mirëmbajtjes së hapësirave publike është i specifikuar në kontratat e komunës së Rahovecit ku në masë të madhe janë të përfshira të gjitha hapësirat tjera duke përfshirë, varreza civile, varreza të Dëshmoreve, lapidare, vegjetacione, breza rrugore apo trotuare, përveç kësaj duke pasur parasysh që komuna e Rahovecit kufizohet edhe me rrugë rajonale, shumë shpesh ka ndodhur që komuna ka mirëmbajtur edhe këto rrugë.

Ne çdo vit ka ndryshime në pozicione të caktuara, specifikisht risi është edhe larja dhe lyerja e lapidareve dhe shtatoreve që janë të vendosur në territorin e komunës se Rahovecit.

Ne specifikime teknike është kërkuar qe edhe deponite ilegale te largohen, vetëm kemi filluar me aksione te gjithmbarshme ne komune për eliminimin e deponive ilegale.

Për me shume detaje dhe sqarime tjera, do te jemi te hapur te diskutojmë gjate mbledhjes së Kuvendit të komunës.

Me respekt,

Drejtoria e Shërbimeve Publike

KOMUNA RAHOVEC

Drejtoria për Shërbime Publike
Adresa: 8 Dëshmorët e Pashtrikut – p.n. Rahovec, Kosovë
Tel: +383 29 276 943
<http://kk.rks-gov.net/rahovec>